

VENDIM
Nr. 205, datë 16.3.2016

**PËR KALIMIN NË PRONËSI, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE BASHKIA VORË,
TË PRONËS NR. 126, ME EMËRTIM “ISH-BRIGADA E TANKEVE”, ME
VENDNDODHJE NË GËRDEC, VORË, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË
VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI
MINISTRISË SË MBROJTJES”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15, shkronja “c”, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të neneve 3, 5, 7 e 8, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi, nga Ministria e Mbrojtjes te Bashkia Vorë, të pronës nr. 126, me emërtim “Ish-Brigada e Tankeve”, me vendndodhje në Gërdec, Vorë, sipas planvendosjes që i bashkë-lidhet dhe është pjesë përbërëse e këtij vendimi, për ta përdorur për ushtrimin e funksioneve të veta administrative, për përmirë-simin e infrastrukturës dhe ofrimin e shërbimeve sociale vendore, krijimin e ambienteve kulturore, sportive, argëtuese e çlodhëse për komunitetin, në territorin juridiksional të Bashkisë Vorë.

2. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar, të hiqet prona nr. 126, me emërtim “Ish-Brigada e Tankeve”, me vendndodhje në Gërdec, Vorë, dhe të shtohet në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i janë transferuar në pronësi apo në përdorim Bashkisë Vorë.

3. Bashkisë Vorë i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përdorimit të pronës nr. 126, me emërtim “Ish-Brigada e Tankeve”, me vendndodhje në Gërdec, Vorë, të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, ta tjetërsojë atë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen ministri i Mbrojtjes, kryetari i Bashkisë Vorë, Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave të Paluajtshme dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

Planvendosje e pronës nr.126
"Ish Brigada e Tankeve", Gërdec, Vorë

586
900



MIRATOHET
Drejtori i Ndermarjes se MEICO-s
Ing. Martin LAZERI

[Handwritten signature]

Shpjeguese:

Sipërfaqja e përgjithshme = 120 607.0 m²


— kufiri i repartit


Shënim:

Kjo planvendosje u punua në zbatim të kërkesës së Drejtorit të MEICO-s, nr.239/610, dt.26.02.2016 dhe mbi planvendosjen e marrë në arkivin e IGJUI-së hartuar në vitin 2004.



586
650





DREJTORI I IGJIU
N/Kolonel Zoti ALCANI



Hartoi
Topograf Nikoll Tushi

A handwritten signature in blue ink, likely belonging to Nikoll Tushi.